



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

AUTORITETI I KONKURRENCËS
RAPORTI I PUNËS 2017

VITI

2017



TË DHËNAT E PUBLIKUARA

Publikuar nga:
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
Adresa:
Ndërtesa e ish “Bankës së Lubjanës”, kati VI
Rruga “Migjeni”, pn. Prishtinë
Tel: 038 200 109 30
Web: <http://ak.rks-gov.net>

Përshkrimi

FJALA HYRËSE	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
KORNIZA LIGJORE.....	6
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	7
FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI	8
AKTIVITETET PËR PERIUdhËN RAPORTUESE	9
RASTET - LËNDËT E TRAJTUARA	9
MARRËVESHJET E NDALUARA/KARTELET	9
1. Rasti i datës: 28.04.2017 - Ministria e Drejtësisë vs Operatorët ekonomik	9
2. Rasti i datës: 28.04.2017 - Viva Fresh vs Komuna e Suharekës	10
3. Rasti i datës: 06.07.201 - Posta e Kosovës (Mbrojtja e zonës së rezervuar)	10
4. Rasti i datës: 05.10.2017 - Sierra LAB	10
5. Rasti i datës: 05.10.2017 - Trusti vs Operatorët ekonomik	11
6. Rasti i datës: 05.10.2017 - AKK vs Floktarët në KK Mitrovicë	11
7. Rasti i datës: 05.10.2017 - Mullisët e Kosovës	12
8. Rasti i datës: 05.10.2017 - Posta e Kosovës (Cenim i veprimtarisë)	13
9. Rasti i datës: 05.10.2017 - Furrтарët e Pejës	13
10. Rasti i datës: 05.10.2017 - Floktarët në KK Lipjan	13
Abuzimi me Pozitën Dominuese	14
1. Rasti i datës: 28.04.2017 - Ankesë - Kompania transportuese “24 Yjet”	14
Përqëndrimet/Bashkimet	14
1. Rasti i datës: 06.07.2017 - Përqëndrimi i realizur BAT mbi BTH	14
2. Rasti i datës: 18.10.2017 - Përqëndrimi i realizuar EMONA mbi CDI Kosovo.....	15
Mendimet Profesionale	16
1. Rasti i datës: 27.02.2017 - Vendim (përmirësues - korrigjiues).....	16
2. Rasti i datës: 08.06.2017 - Mendim Profesional për MPMS.....	16
3. Rasti i datës: 05.10.2017 - Mendim Profesional për ARH-në	17
4. Rasti i datës: 06.12.2017 - Mendim Profesional për MI (Kontrolla teknike)	17
5. Rasti i datës: 22.12.2017 - Mendim Profesional mbi MI (Homologimi).....	18
PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT	19
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	21
PËRFAQËSIMET, ANKESAT DHE KËRKESAT NË GJYKATA	22
MBLEDHJET E MBAJTURA TË KOMISIONIT TË AKK-së	Error! Bookmark not defined.
SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT	28
RAPORTI FINANCIAR	32
RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZAP-it	33
SHTOJCAT	36

FJALA HYRËSE

Valon PRESTRESHI

Kryetar, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Është evidente se ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë, në tërë botën funksionon më së miri. Ekonomia e Republikës së Kosovës ka kaluar nga një ekonomi e planifikuar, në një ekonomi të tregut, duke synuar rritjen e kapaciteteve eksportuese e rrjedhimisht uljen e deficitit tregtar.

Për të siguruar se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e Republikës së Kosovës, konkurrojnë në mënyrë të drejtë dhe të besueshme ndërmjet njëra tjetrës, e të cilat nuk i bashkërendojnë aktivitetet e tyre ekonomike, që të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në ç'rregullimin dhe shtrembërimin e konkurrencës tregtare, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka hartuar dhe miratuar LIGJIN Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS, dhe bashkë me këtë Ligj ka krijuar edhe institucionin e pavarur në bazë të këtij ligji, Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, për t'i parandaluar dhe ndaluar këto

sjellje jo legale të ndërmarrjeve të ndryshme.

Fillimisht, dua ta potencoj faktin se konkurrenca e drejtë është forma më e mirë e mbrojtjes së konsumatorit, andaj duke i luftuar në mënyrë efektive kartelet dhe praktikrat e bashkërenduara të ndërmarrjeve në treg, ne si institucion synojmë që të mbrojmë konkurrencën e drejtë dhe të ju sigurojmë konsumatorëve çmime më të ulëta dhe zgjedhje më të mëdha. Në një mjedis konkurrues, mundësohet një zhvillim më i qëndrueshëm ekonomik.

Konkurrenca po ashtu nxit inovacionin, andaj ndërmarrjet që janë në gjendje të konkurrojnë mund të krijojnë dhe sigurojnë vende të reja dhe të qëndrueshme të punës. Gjatë vitit 2017 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka zhvilluar aktivitete të shumta të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kemi arritur që në një masë mbresëlënëse t'i realizojmë dhe zbatojmë masat legjislative dhe masat zbatuese të MSA-së. Kemi arritur që 100% t'i përmbushim detyrat dhe objektivat të cilat ishin pjesë e Agjendës për Reforma Evropiane.

Në kuadër të kësaj agjende Autoriteti ka draftuar dhe miratuar 6 akte nënligjore, Udhëzimet Administrative për përjashtimin në bllok të marrëveshjeve vertikale dhe horizontale dhe Rregulloren për procedurat hetimore të AKK-së. Autoriteti po ashtu ka hartuar strategjinë për zbatimin e ARE-së, me të cilën është përcaktuar puna dhe udhërrëfyesi konkret në identifikimin dhe hulumtimin e monopoleve në tregun e Republikës së Kosovës.

Autoriteti ka arritur që brenda afateve të bëjë identifikimin dhe hulumtimin e monopoleve në 13 tregje dhe të ofrojë rekomandime të duhura drejt rregullatorëve përkatës. Këtë dokument, Autoriteti e ka dorëzuar në Zyrën e Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Komisionit Evropian. Autoriteti gjithashtu ka siguruar që të jetë përfitues i projektit të madh të Komisionit Evropian IPA 2018. Autoriteti ka trajtuar tetëmbëdhjetë (18) raste gjatë vitit 2017. Ka trajtuar 10 raste "MARRËVESHJE TË NDALUARA/KARTELE", ka trajtuar një (1) rast "ABUZIM ME POZITËN DOMINUESË" ka trajtuar dy (2) raste "PËRQENDRIMEVE" dhe ka dhënë pesë (5) "MENDIME PROFESIONALE".

Shpresoj se ky raport do të ju ofrojë informacione të duhura rreth aktiviteteve të zhvilluara dhe rezultateve që kemi arritur si institucion.

Me respekt,

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Në përputhje me detyrimin ligjor, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) raporton çdo vit në Kuvendin e Kosovës. Raporti Vjetor për vitin 2017 i përshkruan aktivitetet e AKK-së në vitin paraprak dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë aktetë profesionistë rreth funksionimit të AKK-së, duke i siguruar lidhur me transparencën e punës së tij dhe ndërgjegjësimin e ngritur për kulturën e konkurrencës në Republikën e Kosovës. Këto janë pikat kryesore të cilat e shënuan punën e AKK-së në vitin 2017.

Përndryshe organizimi i brendshëm dhe funksionimi i AKK-së janë përcaktuar në Statutin e tij, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës drejtohet dhe menaxhohet nga Komisioni i AKK-së i përbërë nga 5 anëtarë. Komisioni i AKK-së vendos kolektivisht për të gjitha çështjet e konkurrencës, ndërsa kryetari i Komisionit e përfaqëson AKK-në dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e vendimeve të tij. Komisioni miraton vendimet e tij në mbledhjet e tij, me shumicën e votave, ku asnjë anëtar i Komisionit nuk mund të abstenojë nga votimi. Vendimet mund të merren vetëm nëse në seancë janë të pranishëm kryetari ose zëvendëskryetari i Komisionit dhe së paku dy anëtarë të tjerë të tij.

Kryetari dhe katër anëtarët e Komisionit janë emëruar të gjithë për një mandat pesëvjeçar me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kushtet për emërimin, mandatin e anëtarëve të Komisionit dhe fushëveprimin, kompetencat e Komisionit si dhe procesi i vendimmarrjes janë të rregulluara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligjin Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Fushëveprimi i AKK-së konform Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës mbulon: lidhjen e marrëveshjeve të ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve dhe imponimin e detyrimeve të nevojshme për eliminimin e efekteve anti-konkurrese, paraqitjen e keqpërdorimit të pozitës dominuese të ndërmarrjeve dhe ndalimin e çdo sjelljeje që qon në abuzimin e mëtejshëm dhe imponimin e detyrimeve për eliminimin e efekteve anti-konkurrese si dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve.

Përveç aktiviteteve të AKK-së për zbatimin e rregullave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, AKK gjithashtu ka qenë në mënyrë aktive e përfshirë edhe në avokimin e konkurrencës. Konkretisht, AKK ka nxjerrë opinione të ekspertëve lidhur me përputhjen e veprimeve të caktuara me rregullat e konkurrencës, si dhe ka bërë vlerësimin e ndikimit rregullator me komente të tjera për dilemat e parashtruara lidhur me çështjet e konkurrencës. Në kuadër të aktiviteteve primare në fushën e konkurrencës në vitin 2017, AKK ka zgjidh tetëmbëdhjetë (18) raste.

Vlenë të theksohet se sanksionimi nuk ka qenë objektivi i punës së AKK-së. Procedurat e vlerësimit të shkeljeve janë kryer me qëllim të eliminimit të parregullsive në treg, ndërsa me rastin e imponimit të masave ndëshkuese gjithmonë janë marrë parasysht edhe faktorët dhe rrethanat e ndryshme si dhe janë menduar efektet parandalues të vendimit përkatës, duke e marrë parasysht peshën, efektin dhe kohëzgjatjen e shkeljes, fuqinë e tregut të ndërmarrjes në fjalë, veçoritë e veçanta të tregut përkatës, si dhe të gjithë faktet rënduese dhe lehtësuese të rastit.

Viti 2017 ka shënuar një hap të madh përpara për AKK-në por edhe për Kosovën në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. AKK ka marrë ftesë nga OECD për t'u bashkuar me Komitetin e saj të Konkurrencës, si dhe ka marrë pjesë aktive në shumë tryeza të rrumbullakëta. Suksesi është edhe më i madh duke marrë parasysht se Kosova nuk është ende

anëtare e OECD-së. Përpjekjet e saj për t'u bërë anëtare e OECD-së është konfirmuar kohët e fundit, me aktivitetet e zhvilluara në këtë drejtim.

Megjithatë, një numër i rasteve janë mbyllur në vitin 2017 në bazë të zotimeve (masave dhe detyrimeve brenda një afati të caktuar) të ndërmarra nga ndërmarrjet për rivendosjen e konkurrencës efikase në treg. Në vitin 2017, AKK vazhdojë të përdorte zotimet në procedurat e mbylljes së rasteve, pasi ndërmarrjet shpejtë dhe në mënyrë efektive rivendosnin konkurrencën në tregun përkatës, ndërsa procedurat e shkeljeve të gjata dhe gjobat për ndërmarrjet e përfshira janë shmangur. AKK ka pranuar mjetet juridike të cilat janë ofruar vullnetarisht nga ndërmarrjet dhe që eliminojnë efektet e mundshme anti konkurruese atëherë kur nuk ka pasur shkelje në kuptimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, me ç'rast nuk janë shqiptuar as sanksione për ndërmarrjet dhe nuk ka pasur shpenzime të buxhetit të AKK-së.

Të gjitha aktivitetet e ndërmarra gjatë vitit 2017 të cilat janë zhvilluar sipas procedurave të zotimeve përkatëse shërbejnë si dëshmi për AKK-në se detyrimet janë realizuar në afatet e përcaktuara.

Periodha e raportimit dhe sidomos pjesa e dytë e vitit 2017 shënoi një aktivitet në rritje të AAK-së në fushën e kompletimit të legjislacionit sekondar, i cili është një rezultat i drejtpërdrejtë i konsolidimit global Autoritetit dhe forcimit të rolit të tij rregullativ.

Viti i raportimit u karakterizua me konsolidimin e mëtejshëm të disa tregjeve sektoriale të cilat u njoftuan për vigjilencën e rritur të Komisionit të AKK-së dhe gatishmërinë e tij për ndërmarrjen e masave përkatëse ndëshkuese për shkelësit e ligjit.

Në të gjitha rastet e shqyrtuara janë emëruar monitoruesit të ngarkuar me detyrimin për raportim në lidhje me zbatimin e mjeteve juridike sipas vendimeve përkatëse të AKK-së. Versioni integral i Raportit Vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017 përmban një analizë të hollësishme duke u nisur nga pikëpamja e kompleksitetit të procedurave të kryera nga AKK sipas ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, mund të jetë jo fort i kuptueshëm për palët në procedurë, palët e interesit dhe publikun e gjerë. Në raportin vjetor të vitit 2017, AKK jep një përshkrim të hollësishëm të procedurave të shkeljeve të ndaluar dhe shpërdorimit të autorizimi të veprimit të ndërmarrjeve.

Të gjeturat kryesore të monitorimit të tregut nga ana e AKK-së publikohen rregullisht në përputhje me politikën e saj të transparencës dhe me qëllim të promovimit të efekteve të vendimeve, opinionëve dhe veprimtarive të tjera brenda komunitetit të biznesit, konsumatorëve, autoriteteve të administratës publike, akademikëve, ekspertëve dhe publikut të gjerë.

Për detaje më të hollësishme të Raportit vjetor 2017 të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ju lutemi referojuni versionit të tij të plotë në gjuhën shqipe i cili gjendet në faqen e internetit të këtij Autoriteti.

KORNIZA LIGJORE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i ngarkuar për zbatimin e këtyre akteve ligjore dhe nën ligjore, e të cilat janë:

- I. Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- II. Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- III. Statuti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 04-V-312;
- IV. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2011 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative;
- V. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2011 mbi mënyrën dhe kriteret për konstatimin e tregut përkatës - relevant;
- VI. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit;
- VII. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël;
- VIII. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve;
- IX. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 mbi kriteret për lirimin ose uljen e masës administrative;
- X. Rregullore Nr. 01/2016 mbi kushtet dhe rregullat e përdorimit të automjeteve zyrtare të AKK;
- XI. Rregullore Nr. 02/2016 e punës së Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- XII. Rregullore Nr.01-2017 për procedurën hetimore të AKK-së;
- XIII. Udhëzim Administrativ Nr. 02-2017 për përjashtimin grupor të marrëveshjeve horizontale;
- XIV. Udhëzim Administrativ Nr.03-2017 mbi përjashtimet grupore të marrëveshjeve vertikale të ndërmarrësve;
- XV. Udhëzim Administrativ Nr. 04-2017 për përjashtimet grupore të marrëveshjeve në sektorin e transportit;
- XVI. Udhëzim administrativ Nr. 05-2017 për përjashtimet grupore të marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve
- XVII. Udhëzim Administrativ Nr. 06-2017 për përjashtimin grupor të marrëveshjes për d.s.a.m.



Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është i harmonizuar me Direktivat e BE-së, e veçanërisht me Aktet 81, 82 dhe 87 të Komisionit Evropian që në mënyrë të qartë e rregullojnë çështjen e kartelevë, marrëveshjeve të ndaluara dhe përqendrimeve të subjekteve të ndryshme ekonomike në treg. Këto direktiva të BE-së (81, 82, 87) tani janë zëvendësuar me nenet 101-107 të Komisionit Evropian.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT



Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 07 nëntor 2008, në bazë të Ligjit për Konkurrencën Nr. 2004/36.

Autoriteti është person juridik me autorizime publike i cili në mënyrë të mëvetësishme dhe të pavarur i kryen punët duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Qëllimi i mbrojtjes së konkurrencës është para së gjithash krijimi i përfitimeve për konsumatorët dhe krijimi i kushteve të barabarta për të gjitha bizneset në treg, të cilat duke u sjellur në pajtim me rregullat ekzistuese dhe duke garuar në treg me cilësitë, çmimet dhe inovacionet e produkteve dhe shërbimeve të tyre, i kontribuojnë zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë.

Kur kemi të bëjmë me ndërmarrësit dhe sjelljet e tyre antikonkurrese, si për shembull lidhja e Marrëveshjeve me konkurrentët për çmimet, abuzimi me pozitën dominuese ose kontrolli i përqendrimeve, pra bashkimi dhe zmadhimi i ndërmarrësve, Autoriteti e bënë vlerësimin e sjelljeve të tilla

i ndëshkon shkelësit e rregullave dhe ju dërgon mesazhe unike të gjithë pjesëmarrësëve në treg. Pra iniciativat e lira të ndërmarrësve nuk guxojnë të kufizohen, por zhvillimi i tyre kryhet sipas rregullave rigoroze të konkurrencës në treg, të cilat nuk janë vetëm represive, por edhe parandaluese, ndonëse për zhvillimin e konkurrencës efektive kërkohet shumë më tepër e sidomos përforsimi i të kuptuarit dhe ngritja e njohurive lidhur me këto rregulla e cila gjë është objektiv prioritar dhe i përhershëm i Autoritetit.

Një nga detyrat më të rëndësishme të Autoritetit është promovimi i kulturës së konkurrencës dhe hetimi (zbulimi) i kufizimeve të cilat janë të përmbajtura në ligjet dhe rregulloret aktuale të Republikës së Kosovë dhe si të tilla paraqesin pengesa për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe korrekte të ndërmarrësve në treg.

Qëllimi ynë është që t'i kontribuojmë mirëkuptimit të problemit të konkurrencës në treg në të gjitha strukturat e Autoriteteve ekzekutive, legjislative e gjyqësore dhe të marrim pjesë në ndryshimet e tyre, si dhe ta informojmë administratën shtetërore, por edhe shtresat e gjëra të qytetarëve, lidhur me fenomenet të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës.

Nga konkurrenca në fund të fundit përfitojnë të gjithë: konsumatorët, bizneset dhe ekonomia në tërësi. Ajo ofron një ofertë dhe cilësi më të mirë si dhe çmime më të ulëta të produkteve dhe shërbimeve, e inkurajon inovacionin dhe ndikon në rritjen ekonomike. Andaj edhe rritja e ndërgjegjësimit për nevojën e promovimit të saj është detyrë e jona.

FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI

Struktura organizative e Autoritetit

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni që është organ kolegjal vendimmarrës dhe Sekretariati që e përbëjnë nëpunësit civil si staf profesional dhe mbështetës.

Struktura organizative e Sekretariatit

Sekretariati i Autoritetit është organ administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin e rasteve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati pas monitorimit dhe hetimeve harton raportet të cilat paraqiten pranë Komisionit për vendimmarrje.

Sekretariati përbëhet nga dy Departamente:

1. Departamenti Juridik dhe Administratës

Zhvillon politikat kadrovike dhe planet e Autoritetit për menaxhimin e personelit, koordinon procesin e hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, Sekretarin dhe Drejtorët e Departamenteve, siguron përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore të propozuara nga Autoriteti me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*Acquis Communautaire*) si dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Ky Departament në bashkëpunim me Komisionin, Sekretarin dhe Drejtorët e Departamenteve përgatit planifikimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike, siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të KASH-it, SZHMB-së, planit të keshit, pasqyrave e raporteve financiare, barazimet me Thesarin, regjistrimin e të hyrave, si dhe siguron e mbikëqyr shërbimet teknike si mirëmbajtjen, servisimin dhe regjistrimin e rregullt të automjeteve, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi, etj. Ky Departament ka 6 të punësuar dhe ka nevojë edhe për 1 zyrtarë të lartë ligjor.

2. Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut

Mision kryesor ka hetimin e shkeljeve të konkurrencës në treg, ruajtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sipas përcaktimeve të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj.


Ky Departament synon që nëpërmjet zbatimit të procedurave hetimore të parashikuara me ligj, të mbikëqyr tregun dhe të propozojë masat e duhura për rivendosjen e konkurrencës në rastet e pengimit, kufizimit apo shtrembërimit të saj në treg, mbikëqyrë hetimin e tregjeve ku shfaqen praktikant anti-konkurruese, si ato të abuzimit me pozitën dominuese në treg, marrëveshjet e ndaluara dhe nëpërmjet përqendrimeve që krijojnë apo forcojnë pozitën dominuese pas përqendrimit, ruan konfidencialitetin zyrtar dhe tregtar për informacionet e dokumentuara, të marra nga bizneset dhe nga institucionet publike, entet rregullatore, shoqatat profesionale e tregtare dhe palë të tjera të përfshira ose jo nën hetim, etj.

Ky Departament ka 6 të punësuar nga 13 të lejuar (punësimi për pozitat e lejuara do të bëhet gjatë vitit 2018) dhe ka nevojë edhe për 4 inspektor hetues të konkurrencës si dhe 1 zyrtarë të lartë të analizës së tregut.

Zyra për ndihmën shtetërore

Zyra për ndihmën shtetërore deri në muajin shkurt të vitit 2017 ka qenë në kuadër të Autoritetit, por nga muaji mars 2017 është transferuar në Ministrinë e Financave, sipas dispozitave të Ligjit të ri për Ndhimën Shtetërore nr. 05/L-100.

RASTET E TRAJTUARA PËR PERIUDHËN RAPORTUESE



MARRËVESHJET E NDALUARA/KARTELET

1. Rasti i datës: 28.04.2017 - Ministria e Drejtësisë vs Operatorët ekonomik

Është vendosur me Konkluzion për mbyllje të rastit (Ministria e Drejtësisë kundër kompanive ofertuese)

Kërkesa është parashtruar në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës nga Ministria e Drejtësisë me datë 10.10.2014, mirëpo në atë kohë Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk kishte Komisionin funksional e rrjedhimisht ka qenë e pamundur të marrë ndonjë veprim ligjor lidhur me këtë çështje. Nga Ministria e Drejtësisë me datë 30.03.2017 përmes një shkrese - deklarate me shkrim, jemi njoftuar se procedurat në fjalë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë janë zhvilluar dhe kanë përfunduar gjatë vitit 2015, kështu që tani

pas kalimit të një periudhe të gjatë kohore, Ministria e Drejtësisë pajtohet që kjo lëndë të mbyllet. Rasti si i tillë mbyllet sipas nenit 51 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-028 dhe Komisioni konsideron se pala ka heqë dorë nga kërkesa e saj.

2. Rasti i datës: **28.04.2017** - **Viva Fresh vs Komuna e Suharekës**

Është vendosur me Konkluzion për mbyllje të rastit (Viva Fresh vs Komuna e Suharekës)

Pronari i “Viva Fresh Store” Shpk, në Suharekë ka bërë kërkesën e regjistruar me Nr. prot. 55/16-01 me datë. 26.05.2016, me të cilën kërkon konstatimin e shkeljes së konkurrencës së lirë nga ana e Komunës së Suharekës - Drejtoria për urbanizëm, planifikim e mjedis dhe Zyra e kryetarit të Komunës. Kërkesa është në lidhje me dhënien e pëlqimit për hapjen e pikës së shitjes me pakicë - qendër tregtare, sipas standardeve të qendrave tjera të hapura në Kosovë, në pronën të cilën e ka në qirambajtje “NeW Co Ballkan”. Është konstatuar se kërkesa e tillë nuk është në kompetencën e Komisionit, por në kompetencën e Kuvendit Komunal të Suharekës dhe ky rast është mbyllur me Konkluzion.

3. Rasti i datës: **06.07.201** - **Posta e Kosovës (Mbrojtja e zonës së rezervuar)**

Vendim për mbylljen e lëndës për Postën e Kosovës - Mbrojtja e zonës së Rezervuar

Posta e Kosovës Sh.A. ka kërkuar që faturat e zarfuara nga operatorët publik dhe privat të shpërndahen nga vet Posta e Kosovës Sh.A. përndryshe kjo formë e shpërndarjes nga vet operatorët është ndërhyrje në licencën e Postës së Kosovës, e cila ofron shërbime postare dhe komunikim me shkrim. Andaj, menaxhmenti i Postës së Kosovës Sh.A., kërkon nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, që ta trajtojë kërkesën e tyre dhe të ndalojë komunikimin me shkrim ndërmjet subjekteve private dhe publike me qytetarët në formën e pa zarfuar, pasi që këto veprime ndërhyjnë direkt në zonën e shërbimit postar, veprimtari e cila është e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-173 për Shërbimet Postare.

Autoriteti ka shqyrtuar kërkesën, me Nr. Prot. 50/17-02/H dt. 01.03.2017, pas analizimit të lëndës nga të dhënat dhe dokumentacioni në dispozicion vlerësojmë se rasti, respektivisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës, nuk janë objekt i shqyrtimit nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, rrjedhimisht nuk bien nën dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, prandaj Autoriteti nuk trajton lëndët dhe nuk zhvillon procedura për çështjet që nuk i ka në kompetencën e vet.

4. Rasti i datës: **05.10.2017** - **Sierra LAB**

Është vendosur me Konkluzion për mbyllje të rastit (SIERRA - LAB)

Me datë 17.03.2016 Kompania “SIERRA-LAB” Shpk, me seli në Prishtinë ka adresuar kërkesën e saj me nr. prot. 37/16-01/H pranë AKK-së. Kërkesa ka të bëjë me Autorizimin e Trupave për vlerësimin e konformitetit - Laborator testues të kualitetit të naftës dhe derivateve të naftës nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Me këtë shkresë pala i është drejtuar Ministrisë përmes shprehjes së interesit “Autorizimi i më shumë trupave testuese dhe inspektuese për vlerësimin e konformitetit të kualitetit të naftës dhe derivateve të saj” të autorizoj më shumë

se një laborator testues. Pala më këtë ka pretenduar se Ministria kë bërë shkeljen Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës duke krijuar pozitë dominuese në sektorin e kontrollit të kualitetit të naftës dhe derivateve në Kosovë. Pala ka njoftuar se Ministria e Tregtisë pas ankesave të shumta që ka pasur nga operatorët ekonomik që i kanë plotësuar kushtet dhe me datë 20.06.2016, Ministria e ka autorizuar Kompanin “Sierra -Lab” Shpk, për të pas të drejtën për të operuar si laborator testues i naftës dhe derivateve të naftës.

Rasti si i tillë, pasi që pëlqimi apo miratimi i është dhënë nga Ministria përkatëse dhe është në favor të palës pushon të shqyrtohet pranë Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

5. Rasti i datës: 05.10.2017 - Trusti vs Operatorët ekonomik

Është vendosur me Konkluzion për mbyllje të rastit (Trusti vs Kompanitë e sigurimeve)

Me datë 27.10.2014 Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës “TRUSTI” me seli në Prishtinë ka adresuar kërkesën me nr. prot. 2014/1903 pranë AKK-së. Kërkesa e TRUSTI-t ka të bëjë me fillimin e procedurës ndaj operatorëve ekonomik KS “Vienna Insurance Group” dhe KS “Siguria”. Dyshimet e Trustit bazohen se me veprimin e tyre këto kompani siguri kanë bërë marrëveshje të ndaluar lidhur me rastin e dorëzimit të ofertave në prokurimin publik me aktivitetin “Shërbimet e sigurimit fiduciar”. Trusti më kërkesën drejtuar AKK-së mendon se gjatë këtij aktiviteti pasi nuk ka pas ofertues tjerë mendon se ata kanë arritur marrëveshje të ndaluar sipas ligjit të Konkurrencës ku Trusti dëmtohet sepse detyrohet të paguaj më shtrenjtë se sa kur kemi një tender në mënyra të rregullta konkurruese.

Gjatë shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës në mungesë komisionit nuk kemi pas mundësi që në atë kohë ta shqyrtojmë edhe pse ka pas elemente të dyshimit të një marrëveshjeje të ndaluar sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03-L/229. Pas të gjitha aktiviteteve që janë kryer dha ankesave që ka bërë “Trusti” në OSHP i njëjti organ ka anuluar këtë aktivitet prokurimi dhe për këtë lloj aktiviteti të prokurimit KRPP ka rekomanduar edhe tri shpallje tjera publike. Nga dokumentet e shqyrtuara arrijmë në përfundim se aktiviteti i prokurimit për “Shërbimet e sigurimit fiduciar”, janë kontraktuar më kushtet e ekonomisë së tregut dhe se ky proces është kthyer në suaza të ligjit të konkurrencës dhe dyshimet për marrëveshje të fshehtë janë eliminuar.

Rasti si i tillë pushon të shqyrtohet pasi që pëlqimi apo miratimi është dhënë nga OSHP dhe është në favor të palës në bazë të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

6. Rasti i datës: 05.10.2017, AKK vs Floktarët në KK Mitrovicë

Është Konkluzion për mbyllje të rastit (AKK vs Floktarët në KK Mitrovicë)

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare më 17.07.2017, ka autorizuar inspektorët hetues që të inspektojnë tregun relevant në komunën e Mitrovicës, lidhur me dyshimin për marrëveshje të ndaluar në mes të pronarëve (floktarëve) të ndërmarrjeve të cilët merren me (qethjen e flokëve, etj).

Gjatë inspektimit dhe bisedës me disa nga pronarët e salloneve kemi gjetur se ata kanë ngritur çmimet për 50-75 % për shërbimet e tyre përmes një marrëveshjeje. Për të ngritur shërbimet e tyre ata më datë 13.07.2017 janë takuar dhe kanë arritur një marrëveshje të cilën e kanë nënshkruar (21) pronar frizerë të Komunës së Mitrovicës. Gjatë bisedës me ata pas kryerjes së inspektimit në disa sallone kemi arritur të gjejmë një kopje të kësaj marrëveshjeje.

Përcaktimi i tregut relevant - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës nr. 02/2011, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik është konsideruar territori i komunës së Mitrovicës.

Tregu i produktit: 1. Qethja e kokës 2. Rruarja e kokës 3. Rruarja e fytyrës 4. Rruarja me makinë 5. Rruarja me dekorim 6. Pastrimi i kokës.

Gjatë monitorimit të tregut përkatës, mbledhjen e të dhënave dhe deklaratimet e pronarëve të floktarëve në Mitrovicë, kemi konstatuar se pronarët kanë arritur një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga 21 pronar (e cila marrëveshje bie ndesh dhe është e ndaluar apo praktikë e bashkërenduar sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-229, për Mbrojtjen e Konkurrencës), për rritjen e çmimeve në shërbimet e cekura më lartë, mirëpo marrëveshja nuk është zbatuar meqenëse ata pronarë nënshkruar kishin njoftuar përmes njoftimeve në sallonet e tyre se çmimet kanë ndryshuar mirëpo në praktikë nuk është zbatuar kjo marrëveshje.

Gjatë monitorimit të tregut përkatës kemi vlerësuar se marrëveshja është bërë për shkak se pronarët nuk kanë pas njohuri mbi dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229, për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe me këtë rast kemi gjetur se kjo marrëveshje nuk është zbatuar, nuk ka pas impakte në treg e as palë të dëmtuar.

Përfundimisht vlerësojmë se kjo marrëveshje është bërë nga mosnjohja e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për më shumë ajo nuk ka prodhuar ndonjë pasojë për palët e involvuara dhe është cilësuar nga Komisioni si marrëveshje naive e cila nuk ka pasur ndikim apo efekte të çrregullimit të konkurrencës në treg.

7. Rasti i datës: 05.10.2017 - AKK vs Mullisët e Kosovës

Është vendosur me Konkluzion për mbyllje të rastit (AKK vs Mullisët)

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare në bazë të dyshimeve se ka fiksuar të çmimeve në sektorin e grumbullimit, përpunimit dhe shitjes së grurit në Kosovë, nga data 17 - 21 korrik 2017, ka monitoruar tregun relevant dhe ka inspektuar disa operator ekonomik të cilët merren me këtë veprimtari si dhe Shoqatën e Mullisëve të Kosovës.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas analizës dhe krahasueshmërisë së çmimeve të rajonit për grurin dhe miellin është pothuajse i ngjashëm me Kosovën. Kryesisht vendet e rajonit bazohen në berzën e Beogradit dhe Parisit, etj. Grumbulluesit dhe përpunuesit e miellit në Kosovë e përcjellin çmimin duke u bazuar në berzën e Beogradit dhe Parisit, kjo mënyrë e përcaktimit të çmimit të grurit dhe miellit aplikohet edhe në Kosovë.

Në bazë të analizës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vlerëson se nuk vërehet ndonjë koordinim i mullisëve për të përcaktuar çmimin blerës, shitës apo ndonjë kusht tjetër tregtar të grurit dhe miellit në Kosovë, në raport me bujqit dhe në mes tyre.

Ka elemente të ndryshme që paraqiten në tregun përkatës me ankesa të ndryshme të Mullisëve që kemi vizituar mirëpo nga konstatimi del se nga këto shqetësime të tyre nuk përbëjnë shkelje ligjore sepse konkurrenca dhe inovacioni i subjekteve që operojnë në këtë nivel të tregut është brenda parametrave të lejuar të konkurrencës lojale.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka vërejtur se subjektet që operojnë në këtë treg e shohin njëri tjetrin si konkurrent dhe assesi si bashkëpunëtor në ndonjë marrëveshje. Nga takimet kemi vërejtur se ata kanë mjaftueshëm njohuri dhe vetëdijesim për rregullat e një tregu të lirë e konkurrues dhe në bazë të kësaj ata duket se janë konkurrent dhe inovativ në treg.

8. Rasti i datës: 05.10.2017 - Posta e Kosovës (Cenim i veprimtarisë)

Vendim për mbylljen e lëndës për Postën e Kosovës - Cenim i veprimtarisë

Posta e Kosovës Sh.A., në Ankesën e saj kërkon që të ndalohet Konkurrenca jolojale dhe ilegale në dëm të konsumatorëve në tregun e Kosovës, gjithashtu ankuesi njofton edhe për ushtrimin e veprimtarive ilegale të shumë kompanive të cilat veprojnë online përmes rrjeteve sociale, të cilat aktivitetin e tyre e bazojnë në bashkëpunim me kompanitë tjera qoftë të licencuara dhe të regjistruara pranë organeve kompetente. Në ankesën e saj, parashtruesi kërkesës ka potencuar se kompanitë të cilat, janë duke vepruar në tregun përkatës nuk janë kompani të regjistruara, janë fiktive e rrjedhimisht nuk kryejnë as obligimet tatimore, gjithashtu në kuadër të veprimtarive tërësisht informale, qytetarët shpesh bien pre e mashtrimeve tyre sepse me produktet që ofrojnë ato mashtrojnë qoftë në cilësi, por edhe në brendet që i'u vendosin, për t'i mbështetur pohimet e veta në ankesë, pala ka ofruar të bashkëngjitur edhe listën e kompanive ilegale të pa regjistruara në MTI (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) gjegjësisht në ARBK.

Kompetenca lëndore për të vendosur në procedurën administrative caktohet sipas dispozitave me të cilat rregullohet fusha e caktuar administrative ose caktohet si kompetencë e organeve të caktuara. Autoriteti ka shqyrtuar kërkesën, me nr. prot. 70/17-03/H dt. 30.03.2017, pas analizimit të lëndës nga të dhënat dhe dokumentacioni në dispozicion vlerësojmë se rasti, respektivisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës, nuk janë objekt i shqyrtimit nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, rrjedhimisht nuk bien nën dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, prandaj, Autoriteti nuk trajton lëndët dhe nuk zhvillon procedura për çështjet që nuk i ka në kompetencën e vet.

9. Rasti i datës: 05.10.2017 - AKK vs Furrтарët e Pejës

Është vendosur me Konkluzion për fillimin e procedurës hetimore (AKK vs Furrтарët e Pejës)

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare në bazë të dyshimeve për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës me marrëveshje të ndaluar në mes të Furrтарëve, nëpërmjet Shoqatës së Zejtarëve, Hotelierëve dhe Afaristëve në Komunën e Pejës ka nxjerr KONKLuzion për Fillimin e procedurës hetimore ndaj Furrтарëve dhe Shoqatës së Zejtarëve, Hotelierëve dhe Afaristëve të Komunës së Pejës, lidhur me dyshimet për marrëveshje të ndaluar në mes furrtarëve për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës nga 0.30 euro në 0.40 euro. Autoriteti i ka kërkuar të gjitha informatat e nevojshme të pjesëmarrësve në kartel dhe lënda akoma është në procedurë hetimore.

10. Rasti i datës: 05.10.2017 - AKK vs Floktarët në KK Lipjan

Është vendosur me Konkluzion për mbyllje të rastit (AKK vs Floktarët e KK Lipjan)

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare me 12.06.2017, ka autorizuar inspektorët hetues që të inspektojnë tregun relevant lidhur me dyshimin për marrëveshje të ndaluar në mes të pronarëve (floktarëve) të ndërmarrjeve të cilët merren me (qethjen e flokëve, etj) kanë monitoruar tregun përkatës në komunën e Lipjanit.

Përcaktimi i tregut relevant - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës nr. 02/2011, bazuar në analizën e këtij

rasti, tregu gjeografik është konsideruar territori i Komunës së Lipjanit. Tregu i produktit: 1. Qethja e kokës 2. Rruarja e kokës 3. Rruarja e fytyrës 4. Rruarja me makinë 5. Rruarja me dekorim 6. Pastrimi i kokës.

Gjatë monitorimit të tregut përkatës, mbledhjen e të dhënave dhe deklaratimet e pronarëve të floktarëve në Lipjan, kemi konstatuar se pronarët kanë arritur një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga 18 pronar (e cila marrëveshje bie ndesh dhe është e ndaluar apo praktikë e bashkërenduar sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-229, për Mbrojtjen e Konkurrencës), për rritjen e çmimeve 50-65 % në produktet e cekura më lartë, mirëpo marrëveshja nuk është zbatuar meqenëse ata pronarë nënshkruar kishin caktuar datën 15 qershor 2017 si ditë të fillimit të zbatimit në praktikë të kësaj marrëveshje. Gjatë monitorimit të tregut përkatës kemi vlerësuar se marrëveshja është bërë për shkak se pronarët nuk kanë pas njohuri mbi dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229, për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe me këtë rast kemi gjetur se kjo marrëveshje nuk është zbatuar, nuk ka pas impakte ekonomike në treg e as palë të dëmtuar.

Përfundimisht vlerësojmë se kjo marrëveshje është bërë nga mosnjohja e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për më shumë ajo nuk ka prodhuar ndonjë pasojë për palët e involvuara sikundër kësaj cilësojmë si një marrëveshje naive e cila nuk ka pasur ndikim apo efekte të çrregullimit të konkurrencës në treg.

Abuzimi me Pozitën Dominuese

1. Rasti i datës: 28.04.2017 - Ankesë ndaj Kompanisë transportuese “24 Yjet” Sh.a.

Është vendosur me Konkluzion për mbylljen e Rastit ndaj kompanisë për transportin e udhëtarëve “24 Yjet” Sh.a.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës më datë 09.09.2013, ka pranuar ankesën me nr. prot. 145/13, nga ankuesi me pretendimin për keqpërdorim të pozitës dominuese nga Kompania “24 Yjet” Sh.a., e cila si veprimtari, e ka transportin e udhëtarëve në relacionin Hajvali -Prishtinë-Hajvali dhe thekson se:

-Kompania “24 Yjet” Sh.a. për një stacion edhe deri në 100 metra, ka çmimin e biletës prej 0.50 euro dhe nuk ka çmim tjetër më të ulët.

-Kompania “24 Yjet” Sh.a. nuk ka konkurrencë dhe orari i qarkullimit të linjës transportuese nuk respektohet.

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, pas shqyrtimit paraprak të hetimit më datë 28.04.2017, me nr. të prot. 98/17-02/D, ka nxjerrë KONKLuzion me të cilin ka konstatuar se nuk është ç'rregulluar konkurrenca në tregun përkatës në pajtim me dispozitat e Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Përqëndrimet/Bashkimet

1. Rasti i datës: 06.07.2017 - Përqendrimi i realizur BAT mbi BTH

Vendim për Lejimin e përqendrimit të Realizuar BAT mbi BTH

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim dhe plotësimit të lëndës nr. prot. 90/17-02/H, e paraqitur në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji Nr. 04/L-226, (neni 28, paragrafi (1,2), neni 35 paragrafi (2), neni 36, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës

dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar dhe Konkluzionit për Fillimin e Procedurës për Vlerësimin e Lejimit të Përqendrimit, Komisioni i AKK-së ka vlerësuar se:

Zbatimi i këtij përqendrimi nuk do të rezultojë në kufizimin, parandalimin ose ç'rregullimin e konkurrencës në tregjet përkatëse, për shkak të faktit se tregu përkatës do të mbetet shumë konkurrues. Tregu përkatës i CPF në Kosovë është shumë konkurrues dhe dinamik. Të gjithë prodhuesit ndërkombëtarë të duhanit janë të pranishëm në treg duke ofruar një gamë të gjerë të markave të duhanit të njohura në të gjithë botën, të tilla si PMI, Imperial, JTI, Karelia etj. Subjektet e përqendruara do të ballafaqohen me konkurrencë nga të paktën pesë konkurrentë të fortë dhe të besueshëm. Ka elemente konkurruese të çmimit, e cila tregon jo vetëm që ka një nivel të lartë të presionit të konkurrencës në mes të konkurrentëve, por edhe faktin se ka një shkallë të lartë të kalimit në mesin e konsumatorëve të cilët i konsiderojnë produkte e BAT, PMI dhe JTI të jenë të zëvendësueshme.

Studimet e tregut tregojnë se çmimi i duhanit si dhe politika e tatimeve në përgjithësi mund të ndikojnë shumë në stimulimin e konsumatorëve për të ndërruar markat. Duke pasur parasysh se çmimet tashme të larta të cigareve në Kosovë, për shkak të akcizës dhe taksave tjera, çdo rritje shtesë e çmimeve mund të shkaktojë, që një pjesë e madhe e konsumatorëve të kalojnë në marka më të lira brenda të njëjtit segment me të ultë të çmimeve. Marrë në tërësi zgjedhjen dhe ofertën në dispozicion për duhanpirësit dhe rivalitetet intensiv ndërmjet operatorëve, çdo rritje e çmimeve nga subjekti i bashkuar është e kotë dhe do të rezultojë që konsumatorët të bëjnë kalimin duke u larguar nga subjekti bashkuar, tek segmentet më të lira.

Nisur nga argumentet e lartcekura, kemi një treg konkurrues ndërmjet operatorëve ekonomik, vlerësojmë se përqendrimi nuk do të shkaktojë pasoja negative për konkurrencën në tregun përkatës.

Edhe pse, subjekti i bashkuar do të ketë rritje tek pjesa e tregut, çdo formë e shtrebbërimit të konkurrencës do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për çdo sjellje anti - konkurruese. Si përfundim u vendos që të:

- I. LEJOHET, Përqendrimi i Realizuar, ndërmjet përfitimit të kontrollit të British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited (BAT WECTL) mbi/të Bulgar Tabac Holding AD dhe filialeve të tyre.
- II. Nuk vërehen shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të Pozitës Dominuese, sipas Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Rasti i datës: 18.10.2017 - Përqendrimi i realizuar EMONA mbi CDI Kosovo

Emona City përqendrimin e realizuar me CDI Kosovo

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim dhe plotësimit të lëndës nr. prot. 225/17-0/H e paraqitur në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, (neni 28, paragrafi (1,2), neni 35 paragrafi (2), neni 36, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar nr. prot. 244/17-06/D të Njoftimit për realizimin e përqendrimit, Komisioni i AKK-së vlerëson se:

Zbatimi i këtij përqendrimi nuk do të rezultojë në kufizimin, parandalimin ose çrregullimin e konkurrencës në tregun përkatës, për shkak të faktit se tregu përkatës do të mbetet mjaftueshëm konkurrues në Kosovë. Të gjitha shitjet me pakicë dhe shumicë janë të pranishëm në treg duke ofruar shërbime të gjithanshme, etj. Subjektet e përqendruar do të

ballafaqohen me konkurrencë nga të paktën 13 (trembëdhjetë) konkurrentëve të fuqishëm në treg. Ka elemente konkurruese të çmimit, e cila tregon jo vetëm që ka një nivel të lartë të presionit të konkurrencës në mes të konkurrentëve, por edhe faktin se ka një shkallë të lartë të kalimit në mesin e konsumatorëve të cilët i konsiderojnë produktet e kompanisë Emona Shpk si të zëvendësueshme.

Studimet e tregut tregojnë se çmimi i produkteve me shumicë dhe pakicë, si dhe politika e tatimeve në përgjithësi mund të ndikojnë shumë në stimulimin e konsumatorëve për të ndërruar marketet/super marketet e mëdha. Duke pasur parasysh se nëse kompania Emona Shpk do të ngrit çmimet në disa produkte atëherë konsumatori ka zgjidhje dhe mund të furnizohet në supermarketet e tjera në Kosovë.

Nisur nga argumentet e lartë cekura, kemi një treg konkurrues ndërmjet operatorëve ekonomik, vlerësojmë se përqendrimi nuk do të shkaktojë pasoja negative për konkurrencën në tregun në përgjithësi.

Edhe pse subjekti i bashkuar do të ketë rritje tek pjesa e tregut, çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës, për çdo sjellje anti-konkurruese. Si përfundim u vendos që të:

- I. LEJOHET, Përqendrimi i realizuar, ndërmjet përfitimit të kontrollit të pjesës së tyre takuese të aksioneve të CDI - KOSOVO që përbënë 100% të aksioneve në shitje dhe çdo të drejtë që lidhet me aksionet në shitje pa barrë e me efekt nga EMONA Shpk.
- II. Nuk vërehen shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, nuk krijohet pozitë dominuese, sipas Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Mendimet Profesionale

1. Rasti i datës: 27.02.2017 - Vendim (përmirësues - korrigjues)

Vendim (përmirësues-korrigjues)

Me iniciativën e vetë AKK ka konstatuar që pasi palët e kanë pranuar me shkrim Vendimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës me nr. 41/16 i datës 06.12.2016 është bërë një gabim teknik sepse i mungon këshilla juridike. Prandaj në vështrim të nenit 96 të LPA, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës përmirësoi - Korrigjoi pjesën që ka të bëjë me këshillën juridike ashtu që në faqen tetë (8) të Vendimit duhet të shtohet këshilla juridike si në dispozitiv të këtij Vendimi.

2. Rasti i datës: 08.06.2017 - Mendim Profesional për MPMS

Mendim Profesional për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Bazuar në kërkesën e datës 18 Prill 2017 për dhënien e Mendim Profesional mbi nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për shpërndarjen e pagesave të skemës së Ndihmës Sociale ndërmjet MPMS - BPB - PK Sha, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka dhënë këtë mendim:

Në mbështetje të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 28 paragrafi 1 pika 1.7, 1.11, neni 23 pika 1 dhe 2, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës me 8 Qershor 2017 jep këtë mendim profesional, si vijon:

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, vepron në zbatim të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet, në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit të Kosovës, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Autoriteti thekson se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve, të cilët janë potencial për t'u angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) në përgjithësi është e padëshirueshme nga pikëpamja e konkurrencës prandaj rekomandojmë, që numri i konkurrentëve - operatorëve ekonomik të mos kufizohet, dhe të njejtit të mos vendosen në pozita të pafavorshme konkurruese.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomandon Autoritetin kontraktues (MPMS), që t'i referohet Vendimit PSH Nr. 590/15 të datës 30 Dhjetor 2015 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

3. Rasti i datës: **05.10.2017** - **Mendim Profesional për ARH-në**

Mendim Profesional për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARK)

Me datën 10.11.2016 Autoriteti ka pranuar një shkresë (e ripërtërirë me 24.04.2017) nga kompania Railtrans sh.p.k. me pretendimin se NP Trainkos sh.a. është duke abuzuar me pozitën dominuese në tregun përkatës për arsye se:

Ankuesi ka kërkuar nga NP Trainkos sh.a. të ofrojë çmimoren për qasjen në punëtorin e tyre për marrjen e shërbimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave, për arsye se në Kosovë asnjë ndërmarrje tjetër nuk ofron shërbime e punëtori të tillë. 2. Deklarimi i ndërmarrjes Railtrans sh.p.k. ka për qëllim t'i servisojë lokomotivën në punëtorin e NP Trainkos sh.a. dhe është duke pritur një përgjigje për ofrimin e këtij shërbimi mirëpo nuk kanë marrë përgjigje e as shërbimet e kërkuara deri më tani. 3. Sipas ankuesit, NP Trainkos sh.a. është e obliguar të ofrojë këto shërbime sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në bazë të analizës ligjore vlerëson se institucioni kompetent për zgjidhjen e këtij rasti është organi mbikëqyrës i NP Trainkos sh.a dhe NP Infrakos sh.a. brenda hapsirës së veprimit që ofron Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063. Me dispozitat e këtij ligji rregullohet kjo çështje pa qenë e nevojshme që të fillohet me procedurat hetimore nga Autoriteti i Konkurrencës për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese për abuzim me pozitën dominuese të NP Trainkos sh.a. në tregun relevant.

Konsiderojmë se nëse ARH zbaton këto dispozita dhe e obligon NP Trainkos sh.a. për tu futur në marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të tyre ndërmarrësve tjerë siç është e obliguar me ligj atëherë Autoriteti i Konkurrencës nuk mund të ndërhyj përderisa ka hapsirë, kompetenc dhe bazë ligjore me Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës që ARH të ndërmarrë veprime ligjore për zgjidhjen e kësaj çështje. Në rekomandimin e ARH-së i datës 24.11.2016 i është rekomanduar NP Trainkos sh.a. që të lidh marrëveshje me ndërmarrjen Railtrans Sh.p.k. për qasjen në shërbimet hekurudhore që ndërlidhen me shfrytëzimin e pajisjeve speciale hekurudhore të paraqitura në kërkesën e ankuesit.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave si organ mbikëqyrës i tregut hekurudhor në Kosovë inkurajohet që të shfrytëzojë mundësit ligjore për të hapur tregun për ndërmarrjet të reja hekurudhore me qëllim që tregu të gjeneroj zhvillim ekonomik. Me një treg të hapur dhe konkurrues do të ketë shërbime e çmime më të mira për konsumatorin e me këtë rast do të eliminoheshin sjelljet abuzive monopliste në tregun relevant.

4. Rasti i datës: **06.12.2017** - **Mendim Profesional për MI (Kontrolla teknike)**

Mendim Profesional për Ministrinë e Infrastrukturës rreth kontrollave teknike

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për vlerësimin ex post të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, është vënë në funksion pas shqetësimeve të opinionit publik dhe ankesave të operatorëve ekonomik të cilët merren me këtë veprimtari ekonomike, respektivisht nga Qendrat e Kontrolleve Teknike të Automjeteve, me pretendimin se i njëjti është në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, kështu që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe ka analizuar Ligjin Nr. 05/L-132 për Automjete.

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë analizimit të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, vlerëson se neni 87 pragrafi 2 dhe neni 89 paragrafi 3, është në kolizion me Ligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, qëllimin dhe fushën e zbatimit të tij të përcaktuar me nenet 1, 2 dhe 4 par. 1.2, dhe 1.3.
- II. REKOMANDOJMË, Ministrinë e Infrastrukturës që të filloj me plotësim ndryshim të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, përkatësisht Neni 87 paragrafi 2 dhe neni 89 paragrafi 3, me të cilin kufizohet ofrimi i shërbimeve ndaj konsumatorit brenda komunës ku ka vendbanimin pronari i mjetit. Me këtë rast kufizohet konkurrenca, konsumatorëve i'u imponohet zgjedhja e shërbimeve apo produktit brenda një zone të caktuar gjeografike, i kufizon dhe i drejton ata tek operatorë të caktuar komunal apo regjional me rastin e ofrimit të shërbimeve për kontrollimin teknik të automjeteve, prandaj nga pikëpamja e konkurrencës, ligjet dhe rregulloret që kufizojnë numrin e operatorëve ekonomik në tregun relevant dhe kufizimin e marrjes së shërbimeve, nuk janë në përputhje me rregullat dhe praktikën e konkurrencës.
- III. Gjithashtu i rekomandohet ministrisë përkatëse, që ta shqyrtoj dhe ta rishikoj draft udhëzimin administrativ Nr. xx /2017 për Qendrat e Kontrollave Teknike, respektivisht nenet të cilat derivojnë nga dispozitat e kontestuara të Ligjit Nr.05/L-132 PËR AUTOMJETE.

5. Rasti i datës: 22.12.2017 - Mendim Profesional mbi MI (Homologimi)

Mendim Profesional për Ministrinë e Infrastrukturës rreth Homologimit

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për vlerësimin ex-ante të DRAFT-UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE, është vënë në funksion pas shqetësimeve të opinionit publik me pretendimin se i njëjti është në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe ka analizuar DRAFT-UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE. Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me 12.22.2017 ka konstatuar se:

- I. Gjatë analizimit të DRAFT-UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE vëren se neni 3 par. 2, neni 6, 7 dhe 20 par. 2 dhe 3 bien ndesh me Ligjin Nr. 03/L-229 për MBROJTJEN E KONKURRENCËS, konkretisht me Nenin 2, Nenin 4 paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.4.
- II. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomandon Ministrinë e Infrastrukturës që ta rishikoj dhe ta bëjë plotësim ndryshimin e dispozitave në DRAFT-UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE veçanërisht nenin 3, 6, 7 dhe 20.
- III. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, sugjeron - që Autoriteti Homologues (Ministria) të bëjë Liberalizimin e tregut të Homologimit të automjeteve, ta hap tregun në më shumë subjekte afariste duke u bazuar në një konkurrencë të lirë dhe të ndershme të tregut.
- IV. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomandon Ministrinë e Infrastrukturës që në parim, tregu i lirë e përcakton çmimin e shërbimit të Homologimit, meqë rasti karakterizohet si

specifik, atëherë Ministria vendos vetëm për çmimin tavan - maksimal duke mos i detyruar subjektet e autorizuar të kenë çmime unike.

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT

Legjislacioni bazë për fushën e konkurrencës konsiston në Ligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar/plotësuar në vitin 2014. Ky ligj definon rregullat dhe masat për mbrojtjen konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimin e Autoritetit për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe procedurat për implementimin e këtij ligji.

Ligji ofron definicionin e aspekteve relevante të konkurrencës, si: "marrëveshjet, ndërmarrjet, tregu relevant, "pozita dominuese" etj. Ligji gjithashtu përmban dispozita për marrëveshjet e ndaluara, marrëveshjet e tipit kartel, abuzimin me pozitën dominuese, praktikën e ndaluara, përqendrimet dhe bashkimin e ndërmarrjeve, zhvillimin e procedurave hetimore, masat ndëshkuese dhe implementimin e masave ndëshkuese dhe bashkëpunimin me institucionet tjera.

Ligji ka inkorporuar brenda principet, rregullat dhe dispozitat bazike të BE-së për konkurrencë nga Traktati për Funksionimin e BE-së. Gjithashtu pjesërisht ka transponuar Rregulloren e Këshillit 1/2003/KE, Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 773/2004, dhe Rregulloren e Këshillit 139/2004/KE (të ashtuquajturat "Rregulloret bazë të konkurrencës").

Legjislacioni dytësor për implementimin e ligjit bazë të Konkurrencës përbëhet nga 10 aktet legjislative dytësore.

Legjislacioni dytësor që pjesërisht transponon legjislacionin e BE-së përfshin:

- UA nr. 02/2011 mbi mënyrën dhe kriteret për konstatimin e tregut përkatës - relevant, që pjesërisht transponon Njoftimin e Komisionit për Definimin e Tregut Relevant për qëllime të legjislacionit të konkurrencës së Komunitetit (OJ/C 372 e 9 Dhjetorit 1997);
- UA nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël, që pjesërisht transponon Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet e rëndësishme të vogël (de minimis) që nuk kufizojnë konkurrencën sipas nenit 81 pika 1 (tani neni 101) i Traktatit që themelon Komunitetin Evropian (OJ/C 368/13, e datës 22 Dhjetor 2001)¹;
- UA nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve - që transponon elemente të kërkesës dhe kriterëve për bashkimin/përqendrimin të definuar në Rregulloren e Komisionit Nr 802/2004 që zbaton Rregulloren e Këshillit nr. 139/2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve. Megjithatë, kjo rregullore është amendamentuar nga Rregullorja Zbatuese e Komisionit nr. 1269/2013 bashkë me anekse, dhe duhet që legjislacioni jonë dytësor të rishikohet në planin afatmesëm për t'u përafruar më tutje me këtë legjislacion sekondar mjaft voluminoz për përqendrimin.
- UA nr. 07/2012 mbi kriteret për lirimin ose uljen e masës administrative - e cila transponon Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 773/2004 e datës 7 prill 2004 në lidhje me zhvillimin e procedurave nga Komisioni në përputhje me nenet 81 dhe 82 të Traktatit të KE-së e amendamentuar në Rregulloren nr. 2015/1348.

Gjatë vitit 2017 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka vazhduar me nxjerrjen e rregulloreve të reja duke plotësuar legjislacionin sekondar. Në kuadër të përafrimit të legjislacionit janë

¹ https://ak.rks-gov.net/kuadri_ligjor

miratuar rregulloret zbatuese për përjashtimet grupore për marrëveshjet horizontale dhe vertikale e gjithashtu edhe përjashtimet grupore për sektorin e Sigurimeve, sektorin e Transportit dhe sektorin e Distribuit dhe Servisimin e Mjeteve Motorike.

Më poshtë po ju paraqesim rregulloret e hartuara dhe të aprovuara nga Autoriteti të cilin akt të BE-së transpozon dhe një përshkrim të shkurtër për to:

- Rregulloren nr. 01/2017 për Procedurat Hetimore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës - e cila pjesërisht transpozon Njoftimin (BE) e Komisionit për praktikën më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me Nenet 101 dhe 102 të TFBE - OJ/C 308/6.
Kjo rregullore përcakton kushtet dhe procedurat që ndjek Autoriteti gjatë realizimit të hetimeve për rastet të cilat Autoriteti zhvillon hetime.
- UA Nr. 02/2017 për Përjashtimet Grupore - Marrëveshjet Horizontale - i cili pjesërisht transpozon Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 2821/71 e 20 Dhjetorit 1971 për aplikimin e Nenit 81(3), (më parë Neni 85 (3)) i Traktatit të Komunitetit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara
Marrëveshje horizontale është kontratë, një dispozitë e caktuar e kontratës, marrëveshje me gojë apo me shkrim, praktikë e bashkërenduara, që rezultojnë nga marrëveshje të tilla, vendime të ndërmarrësve apo të grupeve të ndërmarrësve, kushtet e përgjithshme të biznesit dhe aktet tjera të ndërmarrësve, që janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes dhe të ngjashme, të arritura ndërmjet dy apo më tepër ndërmarrësve të pavarur të cilët veprojnë në nivel të njëjtë të prodhimit, gjegjësisht distribuit, dhe të cilëve u rregullohen kushtet me të cilët palët e marrëveshjes mund të blejnë, shesin apo rishesin mallrat dhe/apo shërbimet e caktuara.
- U.A Nr. 03/2017 për Përjashtimet Grupore - Marrëveshjet Vertikale - i cili pjesërisht transpozon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 330/2010 për aplikimin e Nenit 101(3) të traktatit për Funksionimin e BE-së për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikën e bashkërenduara.
Marrëveshje vertikale - është kontratë, ndonjë dispozitë e kontratës, marrëveshjet gojore ose me shkrim, praktikë e bashkërenduara që rezultojnë në marrëveshje të tilla, vendimet nga ndërmarrësit ose shoqatat e ndërmarrësve, kushtet e përgjithshme dhe aktet tjera të ndërmarrësve, të cilat janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e kontratës, të lidhura ndërmjet palëve që nuk veprojnë në të njëjtin nivel të prodhimit ose të shpërndarjes, e të cilave i'u parashtrihen kushtet me të cilat pjesëmarrësit në marrëveshje mund të blejnë, shesin apo rishesin mallra dhe/ose shërbime të caktuara.
- U.A Nr. 04/2017 për Përjashtimin Grupor në Sektorin e Transportit - i cili pjesërisht transpozon Rregulloren e Komisionit të BE-së nr. 169/2009, Rregullorja Nr. 3976/87.
Udhëzim Administrativ, përcakton kushtet që marrëveshjet ndërmjet ndërmarrësve, të cilat rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor duhet t'i përmbajnë, si dhe kufizimet ose kushtet që marrëveshjet e tilla nuk mund t'i përmbajnë në mënyrë që të jenë të përjashtuara në grup nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4, të Ligjit nr. 04/L-226 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrësve që rregullojnë transportin ajror nuk mund të përjashtohen në grup në kuptim të këtij Udhëzimi, por mund të përjashtohen nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4, të ndryshim plotësimit të Ligjit dhe nëse në mënyrë kumulative gjatë kohëzgjatjes së tyre i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4, të ndryshim plotësimit të Ligjit.
- UA Nr. 05/2017 për Përjashtimin Grupor të marrëveshjeve në Sektorin e Sigurimeve - i cili pjesërisht transpozon Rregulloren e Komisionit të BE-së nr. 267/2010.

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet të cilat duhet t'i përmbushin marrëveshjet e sigurimeve si dhe kufizimet ose kushtet që këto marrëveshje nuk mund t'i përmbajnë, në mënyrë që të jenë në gjendje të përjashtohen në formë grupore nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4 të ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kompania e sigurimeve nën kontroll të kompanisë tjetër të sigurimeve ose kompania e përqendruar, krijohet sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 1.2 e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës nëpërmjet të kontrollit të drejtpërdrejt apo të tërthortë ose me ndikimin e pozitës dominuese të një apo më shumë ndërmarrjeve (kompanive të sigurimeve) apo pjesëve të ndërmarrjeve (kompanive të sigurimeve).

- UA Nr. 06/2017 për Përjashtimin Grupor në Sektorin e Distributimit dhe Servisimit të Mjeteve Motorike - i cili pjesërisht transpozon Rregulloren e Komisionit të BE-së nr. 461/2010 dhe Rregulloren nr. 1400/2002

Marrëveshje vertikale në sektorin e distributimit dhe servisimit të automjeteve motorike është një kontratë, dispozitë e caktuar e kontratës, marrëveshje me gojë ose me shkrim dhe një praktikë e bashkërenduar që rezulton nga marrëveshje të tilla, vendim nga një ndërmarrës ose shoqatë ndërmarrësish, kushtet e përgjithshme të afarizmit dhe akte të tjera të ndërmarrësve që janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e kontratës dhe të ngjashme, të lidhura ndërmjet ndërmarrësve që nuk operojnë në të njëjtin nivel të prodhimit, ose distributimit dhe me të cilën rregullohen kushtet në të cilat palët në marrëveshje mund të blejnë, shesin ose rishesin automjete motorike të reja, pjesë rezervë për automjete motorike ose ofrojnë shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje të automjeteve motorike.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR



Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në kuadër të bashkëpunimit regional të RCC ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet e organizuara nga RCC, për çështjet e konkurrencës, duke filluar nga trajnimi rreth Praktikave më të mira tek marrëveshjet e Ndaluar - Kartelet, trajnimi i radhës ishte Definimi i Tregjeve, dhe Roli i konkurrencës në sektorin farmaceutik.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në vitin 2010 kishte aplikuar për antarësim në ICN. Pas shqyrtimit të aplikacionit nga ICN Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është pranuar si anëtar i rregullt i kësaj organizate me të drejta të plota. ICN është organizata....

UNCTAD si pjesë integrale e kombeve të bashkuara, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka qenë i ftuar në shumë herë nga organizata në fjalë për të marrë pjesë në Seminaret e organizuar rreth politikave të konkurrencës. Për vitin 2017 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës morri pjesë në punëtorin e organizuar nga UNCTAD rreth temës: Shkëmbimi i informative ndërmjet konkurrentëve

Autoriteti Kosovar i Konkurrences morri pjese ne forumin e organizuar nga Autoriteti Bullgar i Konkurrencës dhe UNCTAD - me qellim të pjesëmarrjes në punëtorine e dhjetë rreth Shkëmbimit të informatave ndërmjet konkurrentëve

Komisioni Evropian-Komisioni i përgjithgjithshëm dhe mobilitet, ne jemi anëtarë të këtij mekanizmi dhe përfaqsimi i Autoritetit tonë është me rëndësi të veçantë. Andaj Autoriteti ishte pjesëmarrës në temën e radhës të organizuar nga SEETO në Shqipëri rreth temës: **fusha e konkurrencës në transportin Hekurudhor.**

Autoriteti Kosovar i Konkurrences ishte pjesëmarrës në takimin e radhës në përvjetorin e 10 të FTC (Federal Trade Commission USA) dhe AZTN të Kroacisë, ku u diskutua nderlidhshmëria e analizave ekonomike të konkurrencës me atë të legjislacionin në fuqi.

PËRFAQËSIMET, ANKESAT DHE KËRKESAT NË GJYKATA TË PARAQITURA NË FORMË TABELARE

AKK kundër KS "ILLYRIA" Sh.a					
Data	Gjykata	Objekti i trajtimit	Refuzohet ose Aprovohet	Ankimimi	Përshkrimi i seancës
23.01.2017 KS "Illyria" Sh.a	Gjykata Supreme e Kosovës	AKTGJYKIM ARJ. Nr. 38/2016 dt. 23.01.2017; Nr. Prot. 23/17-01/H dt 01.02.2017	Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paditurës AKK, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative A.A.nr. 23/2016, datë 31.05.2016;		

AKK kundër KS “SIGMA” Sh.a

Data	Gjykata	Objekti i trajtimit	Refuzohet ose Aprovohet	Ankimimi	Përshkrimi i seancës
13.09.2017	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKK kundër “Sigma” Sh.a, anulim Vendimi nr. 5/5, datë 27.12.2010.			Në seancën e datës 13.09.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim, që AKK në seancë të shqyrtimit kryesor të ofrojë dëshmi në lidhje me Marrëveshjen e dt.03.07.2009, se kush e ka nënshkruar, identifikimi me emër e mbiemër, pozita e punës, a ka qenë i autorizuar apo ka qenë përfaqësues i degës në Gjakovë.
26.10.2017					Në seancën e datës 26.10.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim-Shtyerja e Seancës.
10.11.2017					Në seancën e datës 10.11.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim,
30.11.2017					Në seancën e datës 30.11.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim-Shtyerja e Seancës.
21.12.2017					Në seancën e datës 21.12.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim-Sigurimi i kontratave të punës të përfaqësuesve të degëve të KS “Sigma” Sh.a.

AKK kundër KS “SIGURIA” Sh.a

Data	Gjykatat	Objekti i trajtimit	Refuzohet ose Aprovohet	Ankimimi	Përshkrimi i seancës
13.09.2017	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKK kundër KS “Siguria” Sh.a, anulim Vendimi nr. 5/1, datë 27.12.2010;			Në seancën e datës 13.09.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim që AKK në seancë të shqyrtimit kryesor, të ofrojë dëshmi në lidhje me Marrëveshjen e dt. 03.07.2009, se kush e ka nënshkruar, identifikimi me emër e mbiemër, pozita e punës, a ka qenë i autorizuar apo ka qenë përfaqësues i degës në Gjakovë.
26.10.2017					Në seancën e datës 26.10.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim - Shtyerja e Seancës për dt. 10.11.2017.
30.11.2017					Në seancën e datës 30.11.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim - Shtyerja e Seancës për dt. 21.12.2017.
21.12.2017					Në seancën e datës 21.12.2017, Gjykata ka marrë Aktvendim - Shtyerja e Seancës për dt. 18.01.2018.

AKK kundër KS “CROATIA SIGURIMI” Sh.a

Data	Gjykatat	Objekti i trajtimit	Refuzohet ose Aprovohet	Ankimimi	Përshkrimi i seancës
13.06.2017	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative				Në seancën e datës 13.06.2017, Gjykata merrë këtë Aktvendim që AKK të prezentoj përgjigje nga verifikimi i nënshkrimit të marrëveshjes për paditësin.
07.09.2017	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative				Në seancën e datës 07.09.2017, Gjykata merrë këtë Aktvendim - mbi administrimin e provave.
05.10.2017	Gjykata e Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKTGJYKIM. A.nr. 2416/2014 dt. 07.09.2017 Nr. i prot. 227/17-01/H dt 05.10.2017	APROVOHET kërkesëpadia e paditëses KS “Croatia Sigurimi” Sh.a (tani Dukagjini sha) me seli në Rr. Luan Haradinaj, Prishtinë, ANULOHET Vendimi i AKK nr. 5/3 dt. 27.12.2010 dhe paditësja lirohet nga sanksioni administrative prej 100.000 euro i shqiptuar nga i padituri.		
17.10.2017	Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKK kundër KS “Croatia Sigurimi” Sh.a, Vendimi nr. 5/3 dt 27.12.2010		ANKESË Kundër Aktgjykimit të Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative Anr. 2416/14 dt. 07.09..2017 me Nr. Prot. 254/17-05/D datë 17.10.2017;	

AKK kundër “DUKAGJINI” Sh.p.k

Data	Gjykata	Objekti i trajtimit	Refuzohet ose Aprovohet	Ankimimi	Përshkrimi i seancës
30.11.2017	Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKTGJYKIM A.A.nr. 86/2017	Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurit, AKK në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje		

			Administrative A.nr. 784/16 I dt. 10.01.2017, Vërtetohet; II. Aprobhet ankesa e paditësit "Dukagjini" Shpk me seli në Prishtinë , ndërsa Aktgjykimi i GJTH - DÇA, A.nr. 184/2011 I datës 17.01.2014, Anulohet dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.		
--	--	--	--	--	--

AKK kundër KS "SIGKOS" Sh.a					
Data	Gjykata	Objekti i trajtimit	Refuzohet ose Aprobhet	Ankimimi	Përshkrimi i seancës
12.05.2017	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKK kundër KS "Sigkos" Sh.a, Vendimi nr. 5/9 dt 27.12.201; A.nr.182/2011.			Në seancën e datës 12.05.2017, Gjykata merrë këtë Aktvendim - aprovimi i kërkesës së AKK që "Sigkos" Sh.a të sjellë kontratat e të punësuarve.
18.05.2017					Në seancën e datës 18.05.2017, Gjykata merër këtë Aktvendim- që seanca të shtyhet deri në arritjen e ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë.
20.07.2017					Në seancën e datës 20.07.2017, Gjykata merrë këtë Aktvendim mbi administrimin e provave.
20.07.2017	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKTGJYKIM Anr.182/2011. Nr. Prot 185/17-01/H dt 01.08.2017	Aprovohet si e bazuar kërkesë padia e paditësit KS "Sigkos" Sha, me seli në Prishtinë. Anulohet vendimi i të paditurit AKK në Prishtinë, me nr. 5/9 i dt. 27.12.2017 dhe paditësi lirohet nga sanksioni administrativ prej 100.000 (njëqindmijë) euro e shqiptuar nga i padituri.		
15.08.2017	Gjykata Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative			ANKESE Kundër Aktgjykimit të Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative Anr.182/2011 dt. 20.07.2017 ;Nr. Prot 200/17-05/D datë 15.08.2017;	

AKK kundër KS “DARDANIA” Sh.a

Data	Gjykata	Objekti i trajtimit	Refuzohet ose Aprovohet	Ankimimi	Përshkrimi i seancës
26.10.2017	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	KS “Dardania” Sh.a, kundër AKK për anulim Vendimi nr. 05/10, dt. 27.12.2010 (Sipas Statutit të dt. 14.06.2016, dhe Vendimin me nr. 52-23/2015 nga BQK lidhur me aprovimin e ndryshimit të emrit të kompanisë së sigurimeve nga “Dardania” Sh.a, në “Eurosig” Sh.a)			Në seancën e datës 26.10.2017, Gjykata merr këtë Aktvendim - që AKK në seancë të shqyrtimit kryesor të ofrojë dëshmi në lidhje me Marrëveshjen e dt. 03.07.2009, kush e ka nënshkruar, identifikimi me emër e mbiemër, pozita e punës, a ka qenë i autorizuar apo ka qenë përfaqësuesi i degës në Gjakovë.

AKK kundër “POSTA E KOSOVËS” Sh.a

Data	Gjykata	Objekti i trajtimit	Refuzohet ose Aprovohet	Ankimimi	Përshkrimi i seancës
27.12.2016 “Posta e Kosovës” Sh.a	Gjykatës Supreme në Prishtinë	AKTPADI për Konflikt Administrativ ndaj VENDIMIT të AKK Nr. 41/16 të datës 06.12.2018.			
28.02.2017 “Posta e Kosovës” Sh.a	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKTVENDIM A.nr.2016/2016	Refuzohet, kërkesa e paditëses - kërkuesi “Telekomi i Kosovës” Sh.a në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga Gjykata, shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të paditurit AKK në Prishtinë, me nr. 41/16 të dt. 06.12.2016, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njejtit Vendim.		
28.02.2017 “Posta e Kosovës” Sh.a	Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative	AKTVENDIM A.A nr. 38/2017	Refuzohet ankesa e paditëses - kërkueses “Posta e Kosovës” Sha në Prishtinë. Vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti		

			për Çështje Administrative A.nr. 2016/2016 i dt. 28.12.2016		
05.10.2018 AKK	Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative			PËRGJIGJE NË PADI A.nr 2016/2016, Nr. Prot 250/17-01/D Dt. 05.01.2017	

AKTIVITETET NË ZBATIM TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT (MSA) DHE AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE (ARE)

Zbatimi i MSA-së zhvillohet në kuadër të dy kornizave të planifikimit të politikave: Programit për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ARE). Me fjalë të tjera, PKZMSA-ja është korniza ombrellë, ndërsa ARE-ja shërben si dokument më i fokusuar që paraqet prioritetet afatmesme dhe masa afatshkurtra për diskutime të vazhdueshme ndërmjet palëve nënshkruese të MSA-së, në nivelin më të lartë politik, mbi reformat kyçe që duhet të zbatohet Kosova në procesin e aderimit në BE.

PKZMSA-ja përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave afatmesme (për periudhën e ardhshme pesëvjeçare: 2017-2021) për zbatimin e MSA-së dhe përfarimin e legjisllacionit kombëtar me atë të BE-së, si dhe zbatimin e legjisllacionit të përafuar. Ai përmban masa e prioritetet legjisllative dhe masa e prioritetet zbatuese. Për këto masa Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka raportuar në periudha tremujore siç edhe prashihet në Program.

Agjenda për Reforma Evropiane duhet të shihet si e ndërlidhur me Programin e Kosovës për Reforma Ekonomike, i cili i është dorëzuar Komisionit në janar 2016 dhe mbetet dokumenti kyç gjithëpërfshirës i politikave që udhëheq reformat makro-ekonomike dhe fiskale, përfshirë rekomandimet për përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe zbutjen e trysnisë në tregun e punës. Veprimet prioritare në kuadër të Agjendës për Reforma Evropiane janë identifikuar bashkërisht nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian, në konsultim të ngushtë me INF-të, sektorin e biznesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë.

“Plani i veprimit për zbatimin e prioritetëve kyçe” në kuadër të ARE-së është pjesa kryesore integrale e këtij dokumenti (ARE), e cila parasheh prioritetet e përcaktuara nga qeveria dhe Kuvendi për të filluar zbatimin e reformave ekonomike në të gjithë sektorët e shtetit.

Veprimet konkrete që i ka parasysh Autoriteti dhe të cilat janë pjesë e zbatimit të ARE-së, për fushëveprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës janë:

E. 1 Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme të AKK-së;

E. 2 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatisë një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun e Kosovës, me rekomandimet e duhura.

AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE përkatësisht pika E.2 ngarkon Autoritetin Kosovar të Konkurrencës të hulumtojë dhe përgatisë një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun e Kosovës, me rekomandimet e duhura.

Mënyrën e përcaktimit të Pozitës Dominuese dhe Monopoleve, Autoriteti i Konkurrencës e ka bërë duke u bazuar në qarkullimin vjetor të ndërmarrjeve që operojnë në të njëjtin treg, përpjestuar me qarkullimin vjetor të ndërmarrjes specifike.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka bërë hulumtimin dhe identifikimin e monopoleve në Republikën e Kosovës për 13 tregje dhe njëkohësisht ka nxjerr informata mbi strukturën e tregut të ndërmarrjeve dhe pozitën e tyre dominuese të përcaktuar me LIGJIN Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS. Autoriteti i Konkurrencës këtë raport i ka dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë dhe Komisionit Evropian.

Tregjet për të cilat Autoriteti ka bërë hulumtimin dhe ka dhënë rekomandimet janë:

Tregu i Telekomikacionit	Tregu i Energjisë	Tregu i Sigurimeve	Tregu i derivateve të naftës	Tregu i produkteve farmaceutike
Tregu i Transportit	Tregu i mediave dhe produksioneve kinematografike	Tregu i sektorit bankar	Tregu i paisjeve fiskale	Tregu i lojërave të fatit
Tregu i minierave	Tregu i mbeturinave	Tregu i funizimit me Ujë		

- Gjithashtu Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka përgatitur edhe raportet (Inputet) për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin përkatës.
- Autoriteti i Konkurrencës ka marrë pjesë dhe ka dhënë kontributin e tij për Kapitullin e 8, në takimet e organizuara në Nën-komitetin e Stabilizim Asociimit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën. Takime këto të mbajtura në Bruksel dhe Prishtinë.

SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vazhdon të jetë i ballafaquar me sfida si të aspektit teknik, organizativ e funksional, siç janë:

1. Ligji 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës është ndryshuar me plotësim ndryshimin nr. 04/L-226 ndërsa sfida në vete mbetet që ky Ligj të harmonizohet me Direktivat e BE-së, të ndryshohet dhe t'i përshtatet rrethanave lidhur me konkurrencën në vendin tonë dhe më gjerë.
2. Statuti i Autoritetit të harmonizohet me Ligjin në fuqi pasi që nuk është ndryshuar fare nga Ligji i parë i Konkurrencës 2004/36.
3. Aktet nënligjore të cilat janë hartuar në periudhën deri sa Komisioni ishte në mungesë duhet harmonizuar me direktivat e BE-së dhe ligjet në fuqi, sa i përket Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve të hartuara gjatë vitit 2017 të gjitha janë të harmonizuara me direktivat e BE-së.
4. Avokimi me Gjyqësorin.
5. Avokimi me bizneset e mëdha, të mesme dhe të vogla.
6. Avokim me mediat të cilat janë një faktor shumë i rëndësishëm.
7. Ngritjen e kapaciteteve (trajnimi) të stafit në përgjithësi.
8. Monitorimi dhe fillimi i procedurave për shkelësit e Konkurrencës (*sipas detyrës zyrtare*) ex officio.
9. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të jetë në nivel më të lartë, përmes Memorandumeve të Bashkëpunimit.

Tani kur shumica e sfidave të përmendura janë tejkaluar, besojmë se edhe ato të mbeturat, bazuar në zotimet e Komisionit të Autoritetit do të eliminohen, aq më tepër kur kemi të bëjmë me faktorë kryesisht formal, sikurse që janë buxheti, stafi i pamjaftueshëm dhe mbështetja jo e mjaftueshme nga komuniteti i biznesit dhe konsumatorët, etj.

Prandaj gjatë vitit 2018, me kushte të reja dhe mobilizim plotësues Autoriteti do të përgatitet për pjesëmarrje aktive në punën e organeve dhe grupeve punuese të rrjetit Evropian për mbrojtjen e konkurrencës në treg, me të cilat bashkëpunimi është i detyruar.

Përgatitjet më të rëndësishme megjithatë janë duke u bërë për përfundimin e aktivitetit të Autoritetit lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe të dispozitave tjera nga ky fushëveprim me qëllim që të fuqizohet konkurrenca në treg në Republikën e Kosovës dhe ndërmarrësit Kosovar të largohen (zmbarsen) nga thyerja e këtyre dispozitave ligjore, kurse në rastet kur kemi të bëjmë me shkeljet e rënda të dispozitave ligjore, ata të ndëshkohen në mënyrë meritore për sjelljet antikonkurruese në treg.

Në të gjitha këto veprimtari përfaqësuesit e Autoritetit janë aktive në diskutime me çështjet e trajtuara, si dhe parashtrojnë zgjidhjet e rasteve të shqyrtuara nga ky autoritet. Autoriteti i Konkurrencës synon të zhvillojë politikën e konkurrencës, duke forcuar bashkëpunimin me strukturat homologe të konkurrencës.

Rekomandimet e Autoritetit për vitin 2018

Viti 2017 korrespondon me vitin e parë të plotë, pas funksionalizimit të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, pas tri viteve të pasivitetit të tij, sepse ai definitivisht në formacion të plotë u emërua me 09.06.2016.

Në përputhje me objektivat strategjike dhe operacionale të përcaktuara për vitin 2017 dhe në përputhje me dispozitat e pikës së dhjetë të paragrafit të parë të nenit 28 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, si dhe të pikës së parë të paragrafit të dytë të nenit 12 të Statutit, Autoriteti rekomandon si prioritet të politikës së konkurrencës për vitin 2018, këto aktivitete:

1. Përgatitja e një plani të punës për periudhën 2018 - 2021.
2. Hartimi i akteve nënligjore që janë në mungesë.
3. Krijimi i një baze të të dhënave, përmes të cilës do të bëjmë grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre.
4. Përgatitja e disa pamfletëve bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përmes të cilave duhet kushtuar një rëndësi të madhe rritjes së ndërgjegjësimit publik për përfitimet që vijnë nga konkurrenca apo rritjen e kulturës së konkurrencës.
5. Bashkëpunimi me rregullatorët tjerë të tregut, përmes të cilëve synojmë të bëjmë transparencën e veprimtarisë së punës së AKK-së, nëpërmjet pasqyimit të detajuar të tij në faqen zyrtare, duke rritur vazhdimisht bashkëpunimin me entet e ndryshme publike, veprimtaria e të cilëve mund të ketë ndikim në konkurrencë.

Parimet udhëheqëse mbi bazën e të cilave zbatohet ligji, politikat konkurruese dhe veprimtaria e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës janë:

1. Barazia.
2. Zbatimi i parimeve të konkurrencës në mënyrë që nuk lejon diskriminim të ndërmarrjeve ekonomike në rrethana të njëjta.
3. Gjithëpërfshirja nënkupton një zbatim të gjerë të parimeve rregullatore dhe të konkurrencës në veprimtari ekonomike, ku hyjnë: veprimtaritë e biznesit privat dhe atij

publik, njohjen e përmasave të konkurrencës në politikat e zhvillimit dhe reformat që ndikojnë në funksionimin eficient të tregjeve, mbrojtjen e procesit të konkurrencës dhe krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi për konkurrence të lirë eficiente dhe efektive.

Prioriteti i parë

Autoriteti do ta forcojë aftësinë e tij për zbulimin e praktikave të kufizimit të konkurrencës dhe atë sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) si një mjet thelbësor për hetimin dhe sanksionimin e veprimeve të paligjshme, me qëllim të zhbindjes (zmbiapjes) së sjelljeve ilegale dhe në këtë mënyrë të ndikojë në rritjen e stimujve të konkurrencës për kompanitë që të garojnë në mes vehti me anë të meritës.

- a. Në veçanti, lidhur me prokurimin publik, Autoriteti do të vazhdojë të punoj për analizimin e informacionit për procedurat e prokurimit publik në sektorët e shpenzimeve të rëndësishme publike kombëtare, me qëllim të identifikimit të gjurmëve të marrëveshjeve të fshehta.
- b. Në mënyrë që të rritë veprimtarinë hetimore në vitin 2018, do të bashkëpunojë me parashtruesit e ankesave, si një nga burimet kryesore të informacionit për zbulimin e praktikave kufizuese. Për këtë qëllim, do të zhvillohet zbatimi i ankesave të reja në portalet elektronike, si dhe do të instalohet një linjë e dedikuar telefonike. Këto instrumente pretendojnë për ta lehtësuar paraqitjen e ankesave për Autoritetin nga qytetarët dhe kompanitë të cilët janë viktima potenciale të sjelljes anti konkurruese, ose të cilët janë në dijeni të praktikave të paligjshme. Këto instrumente do të sjellin efikasitet më të madh operacional për zhvillimin e shpejt dhe në mënyrë efektive të hetimeve.
- c. Gjatë vitit 2018, Autoriteti në vazhdimësi do t'i përmirësojë procedurat e saj të brendshme në mënyrë që ta zvogëlojë kohën për hetimin e kufizimeve të konkurrencës dhe për të rritur sigurinë juridike për kompanitë.
- d. Në vitin vijues 2018, për luftimin e praktikave të cilat e kufizojnë konkurrencën do të përdoren mjetet hetimore efikase dhe të kombinuara. Gjatë këtij viti Autoriteti do të përdorë mjetet më të përshtatshme për nxjerrjen e dëshmive, duke e bërë konsolidimin e procedurave për kryerjen e hetimeve, veçanërisht në ambientet digjitale, si dhe për trajtimin e provave të mbledhura. Ai do të ketë përfitime edhe nga mos respektimi i skadencave të afateve ligjore për ushtrimin e ankesave lidhur me Aktgjykimet e nxjerra jo përfundimtare.

Prioriteti i dytë

Luftimi karteleve në ekonominë e Republikës së Kosovës.

Në vitin 2018, lufta kundër karteleve do të jetë njëri prej prioritetëve të Autoritetit, sepse ato i sjellin dëm ekonomisë kombëtare dhe konsumatorëve, qofshin ata si ndërmjetësues ose si akterë të fundit.

Koordinimi në mes të kompanive konkurruese, duke i fiksuar çmimet, mandej duke e bërë ndarjen e tregjeve gjeografike ose të konsumatorëve, apo duke e bërë kufizimin e prodhimit në atë mënyrë e cila mundëson rritjen e çmimeve, është shkelje më e rëndë e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Autoriteti do ta bëjë promovimin e luftës kundër karteleve, pavarësisht nga lloji ose forma konkrete e Marrëveshjes së tregut relevant (përkatës), apo të madhësisë së kompanive, duke i kushtuar vëmendje të veçantë prokurimit publik, por edhe marrëveshjeve të cilat ndikojnë te konsumatorët e fundit në mënyrë më të drejtpërdrejtë.

Në këtë kontekst, Autoriteti do ta vendosë në prioritetet e aktivitetit të saj edhe promovimin e programit të lehtësimit të ndëshkimeve, i cili siguron imunitet ose ulje të gjobave për kompanitë apo për administratorët, nëse ata e pranojnë pjesëmarrjen e tyre në një kartel dhe

nëse bashkëpunojnë me hetuesit e Autoritetit. Rritja e ndërgjegjësimit për programin e lehtësimeve do t'i përfshijë edhe palët e angazhuara të interesit, duke përfshirë komunitetetet ligjore dhe të biznesit në Republikën e Kosovës.

Programi i lehtësimit (*zbutjes*) do të përforcohet edhe më tej me miratimin e vendimeve sanksionuese. Këto vendime do të jetë ligjërishit dhe ekonomikisht të shëndosha dhe do të parashikojnë sanksione të duhura për objektivat e parandalimeve të veçanta dhe të përgjithshme.

Pas deklarimeve të dhëna në vitin 2016 për t'i luftuar manipulimet e ofertave në prokurimin publik, Autoriteti do të bashkëpunoj ngushtë me organet vendimmarrëse dhe organet tjera përgjegjëse në prokurimin publik. Ky bashkëpunim ka për synim shkëmbimin e praktikave më të mira të cilat e lehtësojnë jo vetëm parandalimin, por edhe zbulimin e marrëveshjeve të fshehta në procedurat e prokurimit publik.

Prioriteti i tretë

Praktikat tjera të cilat e kufizojnë konkurrencën në ekonomi.

Përveç luftës kundër karteleve, prioritetet e Autoritetit gjithashtu përfshijnë edhe hetimin dhe sanksionimin e kufizimeve vertikale të konkurrencës, të tilla si ruajtja e çmimeve të rishitjes ose mbrojtja absolute territoriale e distributorëve, si dhe abuzimi me pozitën dominuese.

Marrja e vendimeve me transparencë

Përdorimi i sanksioneve për shkeljet e ligjit të konkurrencës duhet të bazohet në rolin e tyre për parandalimin e veçantë dhe të përgjithshëm, të të penguarit e shfaqjeve dhe sjelljeve të paligjshme.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij për ndëshkim në përputhje të plotë me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, Autoriteti do t'i zbatoj sanksionet në përputhje me udhëzimin e publikuar për aplikimin e gjobave.

Në vitin 2018, Autoriteti do të vazhdojë t'i promovojë procedurat e zgjidhjeve dhe të angazhimeve, në të cilat kërkohen, instrumentet me përfitime në aspektin e arritjeve të efikasitetit të procedurave.

Në veprimtarinë e tij, Autoriteti do t'i kushtojë vëmendje të afërt të drejtave të mbrojtjes dhe procesit të rregullt.

Kontrolli më efikas i bashkimit (*përqendrimit*)

Në kontrollin e bashkimit (*përqendrimit*), Autoriteti do t'i përcaktoj si prioritet shpejtësinë dhe efikasitetin e veprimeve të tij dhe atë si në bashkimet komplekse ashtu edhe në ato jokomplekse. Autoriteti do të synojë reduktimin e barrës burokratike të palëve në procedurat e kontrollit të bashkimit.

Në vitin 2018, Autoriteti do ta zvogëlojë kohëzgjatjen mesatare të procedurave të bashkimit, rreth 5% deri në 10%.

Autoriteti gjithashtu do të përforcojë zbulimin e bashkimeve (*përqëndrimeve*) të cilat, pavarësisht nga përmbushja e kriterëve të njoftimit, nuk janë paraqitur tek Autoriteti.

Qëllimi i Autoritetit është ruajtja dhe zhvillimi i interesit të konsumatorëve të ndërmjetëm dhe të atyre të fundit, në konkurrencën efektive në treg, siç parashihet në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

RAPORTI FINANCIAR

Raportimi financiar është sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme dhe përmbushë të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe nga Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116, nr. 04/L-194, nr. 05/L-004, nr. 05/L-063 dhe nr. 05/L-007.


Të dhënat janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur. Zhvillimet buxhetore të AKK-së në vitin 2017, ishin si në vijim:

Buxheti i ndarë ishte 243,517.78 € dhe ky buxhet ishte i dedikur: 170,656.78€ për paga dhe mëditje, 59,861.00 € për mallra dhe shërbime dhe 13,000.00 € për shpenzime komunale. Alokimi i fondeve është bërë në bazë të planit të rrjedhës së parasë, të përgatitur nga Zyrtari kryesor financiar - ZKF në bashkëpunim me Menaxhmentin e AKK-së.

Buxheti i lejuar dhe i shpenzuar sipas kategorive:

Nr.	Kategoria	Buxheti i lejuar	Buxheti i shpenzuar	Përqindja e shpenzuar
1.	Paga dhe mëditje	170,656.78	170,656.78	100.00%
2.	Mallra dhe Shërbime	59,861.00	43,586.37	72.81%
3.	Shpenzime Komunale	13,000.00	9,919.25	76.30%
	TOTALI	243,517.78	224,162.40	92.05%

Periudha e raportimit është nga 01.01.2017 deri më 31.12.2017



RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZAP-IT

RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZKA-së

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka përgatitur planin e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit - ZKA, në bazë të raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2016.

Në vijim po japim të gjeturat, rekomandimet, veprimet e menaxhmentit, datat e planifikuara të përfundimit të veprimit të menaxhmentit dhe personin përgjegjës.

Nr.	E gjetura Rekomandimi	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
1.	E gjetura Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se: * Në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, burimet dhe shfrytëzimi i fondeve janë mbivlerësuar për 2,500€; Në raportin e ekzekutimit të buxhetit nuk janë prezantuar të hyrat e pranuar në vlerë 3,000€ ndonëse janë shpalosur në shënimin 14; dhe * Blerjet e pasurive jo-kapitale (furnizime për zyre dhe kompjuterë) në vlerë 13,083€ nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurisë. Këto gabime reflektojnë mungesën e një rishikimi kritik të PFV-ve dhe dobësi në menaxhimin e pasurive. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje. Rekomandimi Kryetari i AKK-së duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i parandaluar gabimet në PFV-të e vitit 2017 dhe për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive.	* Shuma prej 2,500€ është gabim teknik dhe sikur auditoret të na thirrnin në konsultime siq është rregull, do të përmirsohej me kohë në PVF, * Shuma prej 3,000€ ende për auditorët është e paqartë se a duhet apo nuk duhet të evidentohen në PVF, sepse këto janë të hyra që direct shkojnë në buxhetin e Kosovës. Auditoret e auditimit të vitit 2015 nuk kanë dhënë vërejtje për të njëjten çështje, * Blerjet e pasurive jo-kapitale (inventari për zyra dhe kompjuterët) në vlerë 13,083€ do të regjistrohen në regjistrat e pasurisë sa	31.12.2017.	Zyrtarja e lartë për buxhet e financa dhe Zyrtari i pasurisë

		më parë që të jetë e mundur.		
2	E gjetura Asnjë rekomandim i vitit të kaluar nuk është zbatuar plotësisht, sepse AKK nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim identifikohen dhe adresohen. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjithë organizatën. Rekomandimi Kryetari i AKK-së duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.	Konstatimi juaj se asnjë rekomandim i vitit të kaluar nuk është zbatuar plotësisht është i padrejtë, si edhe në vitet e kaluara shumica e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht apo pjesërisht. Angazhimet tona do të jenë të përherëshme që rekomandimet tuaja të zbatohen plotësisht.	31.12.2017.	Sekretari i AKK-së
3	E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se: * Ndonëse janë ndërmarrë hapa për menaxhimin e rrezikut ky proces ende nuk është në nivelin që kërkohet me procedurat e MFK-së. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se përgjegjësia për zhvillimin e menaxhimit të rrezikut nuk është alokuar në mënyrë të qartë brenda organizatës; * Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) ende nuk janë të vendosura nga AKK dhe * Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit konsiderohen të vendosura mirëpo raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore dhe nuk janë të cilësisë së kërkuar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë së pyetësorit nga ana e AKK-së dhe	Edhe gjatë vitit 2015 si edhe tani për vitin 2016, kemi rekomandime rrethë pyetësorit të vet-vlerësimit. Me përpikmëri si në vitin 2015 edhe në vitin 2016 i jemi përmbajtur udhëzuesit për plotësimin e pyetësorit të vetvlerësimit dhe defektet janë në përpilimin e këtij pyetësori. Për vitin 2017 gjatë plotësimit do të kërkojmë më shumë spjegime nga përpiluesi, për të qenë edhe kjo çështje në rregull.	31.12.2017.	Sekretari i AKK-së

	rëndësinë se tij për t'i mbështetur përmirësimet operative. Rekomandimi Kryetari i AKK-së duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar adresimin e çështjeve të identifikuara. Kryetari i AKK-së po ashtu duhet të sigurojë që është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojë raportim dhe monitorim sistematik për zbatimin e kërkesave të këtij procesi.			
4	E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të AKK-së ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat. Kjo ka ndodhur për shkak të mos mbajtjes së takimeve të rregullta me zyrtarët përgjegjës dhe se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth ndryshimeve në realizimin e buxhetit. Rekomandimi Kryetari i AKK-së duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2016.	Ne konsiderojmë se nuk kemi dobësi në raportimet financiare për shpenzimet dhe të hyrat. Për ndryshimet në buxhet pa dijen dhe pa dëshirën tonë përgjegjësia i bie MF-së.	31.12.2017.	Zyrtari kryesor financiar dhe Zyrtarja e lartë për buxhet e financa
5	E gjetura Auditimi ynë i pagave ka identifikuar që një i punësuar pozita e të cilit është themeluar me Ligjin e Punës ka përfituar shtesën e shërbyesit civil në vlerë 30€ për muaj. Kjo ka ardhur si rezultat i mosfunksionimit efektiv të kontrolleve për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet në fuqi Rekomandimi Kryetari i AKK-së duhet t'i forcojë kontrollet për të siguruar pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret për kompensimin e punonjësve. Kompensimi i të gjithë	Me QA të MAP-it nr. 01/2014 të datës 08.12.2014, për pozitën e vozitësit është kërkuar ndrrimi i statusit nga shërbyes civil në stafë mbështetës, por nuk është kërkuar edhe ndërprerja e shtesës prej 30€ për SHC.	10.07.2017.	Zyrtarja e lartë e personelit

	punonjësve që kanë themeluar kontratë me Ligjin e punës duhet të jetë subjekt i këtij ligji dhe ndryshimet e nevojshme duhet të reflektohen me kohë në listën e pagave.	Në mëshitetje të rekomandimit tuaj që nga muaji korrik 2017 kemi bërë ndërprerjen e kësaj shtese.		
6	E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar që AKK nuk e kishte përmbushur obligimin e saj për inventarizim e pasurisë në fund të vitit. Kjo kishte ndodhur për shkak të ndërrimit të lokacionit të AKK-së. Rekomandimi Kryetari i AKK-së duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Rregullores për menaxhimin e pasurisë. Rëndësi e theksuar duhet t'i kushtohet procesit të inventarizimit në fund të vitit për të siguruar që e tërë pasuria është në gjendje të mirë dhe në shfrytëzim për qëllimin e përcaktuar.	Gjatë vitit 2016 kemi qenë të akomoduar në objektin e ish Gjykatës Themelore të Prishtinës, me inventar të Kuvendit të Kosovës dhe të MAP-it. Inventari ynë ka qenë i magazinuar në depo të Kuvendit dhe inventarizimi i tij ka qenë i pamundur. Nga fillimi i vitit 2017 jemi akomoduar në ish-objektin e Bankës së Lubjanës dhe tani janë krijuar kushtet që të bëjmë inventarizimin e gjithë inventarit të AKK-së.	31.12.2017.	Zyrtari i pasurisë

SHTOJCAT

ORGANOGRAMI I AKK-së

K O M I S I O N I	
Kryetari	(1)
Zëvendëskryetari	(1)
Anëtarët	(3)

SEKRETARIATI

Sekretari

(1)

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE ADMINISTRATËS Drejtori (1)	DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES SË TREGUT Drejtori (1)
Zyrtari i Lartë Ligjor (1)	Inspektori Hetues i Konkurrencës (5)
Zyrtari i Lartë për Buxhet e Financa (1)	
Zyrtari i Lartë i Personelit (1)	
Asistenti Ekzekutiv (1)	
Vozitësi (1)	